



USHTRIA



Viti i 72-të i botimit Nr. 13 (827610)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 29 Mars 2019

GJENERAL BRIGADE KOLLÇAKU-GJENERAL BRIGADE MAIOCCO



FA në stërvitjet të drejtuara nga SHBA dhe NATO

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku priti më 29 mars, në një takim pune Komandantin e Mbështetjes së Misioneve në Komandën e Bashkuar Amerikane në Europë, gjeneral brigade Frederick Maiocco, i cili zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë në kuadër të 10 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

Gjeneral Kollçaku pasi vlerësoi bashkëpunimin e sukseshëm në fushën e mbrojtjes mes FA shqiptare dhe atyre të SHBA dhe kryesisht në drejtim të rritjes së kapaciteteve ushtarake të FARSH dhe rolit të tyre në kompletimin e grup batalionit të këmbësorisë dhe certifikimin "Full Combat Ready". Kompletimi me automjete të blinduara HMMWV... >>> faqe 4

Xhaçka: Shqipëria, aset strategjik në rajon



>>> faqe 2

Shqipëria 10 vjet në NATO

Xhaçka: Anëtarësimi në NATO, më shumë se një çështje sigurie

Festohet 10-Vjetori i Anëtarësimit në NATO. Marrin pjesë Presidenti Meta, Kryeministri Rama, Ministria Xhaçka, shefi i Shtabit të FA Gjeneral brigade Kollçaku, ministria italiane Trenta, ajo maqedonase Shekerinska, i Kosovës Berisha, etj. >>> faqe 3

Komanda e Aleancës për Transformim

Admiral Nielson vlerëson kontributin e Shqipërisë në NATO

Në kuadër të 10-Vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe me ftesë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku zhvilloi një vizitë në vendin tonë zëvendës komandanti i Komandës së Aleancës për transformim, admiral Manfred Nielson. Pas ceremonisë së pritjes, admiral Nielson zhvilloi takime...



>>> faqe 5

Batalioni i Forcave Speciale

Realizohet me sukses stërvitja "GJALLICA-19"

Nga data 19-21 mars, batalioni i Forcave Speciale të Forcës Tokësore, zhvilloi stërvitjen "GJALLICA-19" në zonën e Lugut të Keq, Kukës. Në këtë stërvitje morën pjesë Kompania e Parë dhe Kompania e Katërt e Aksioneve Speciale Direkte, e mbështetur dhe nga një helikopter "Cougar" i Forcës Ajrore. "GJALLICA-19", kishte për qëllim standartizimin dhe përmirësimin e procedurave standarte të veprimit në kryerjen e operacioneve speciale, (zbulim special dhe goditje... >>> faqe 8



BASHKËPUNIMI NATO-GJEORGJI

Stoltenberg: Të përgatisim Gjeorgjinë për anëtarësimin në NATO

>>> faqe 10

70 VJETORI I NATO-S DHE 10-VJETORI I ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË

SHBA: Roli i Shqipërisë në Aleancë, shembull për vendet aleate

faqe 7

SHQIPËRIA-10 VJET NË NATO

Samitit të Strasburgut i parapriu Samiti i Bukureshtit

NGA DASHNOR DERVISHI

faqe 6

Shqipëria 10 vjet në NATO

Xhaçka: Shqipëria, aset strategjik në rajon

10 vjet më parë Shqipëria u pranua si anëtare e Aleancës më të madhe ushtarake që ka njohur ndonjëherë historia

Një dekadë pas anëtarësimit në NATO, Shqipëria ia ka dalë të jetë një partner i besueshëm dhe një aset strategjik në rajon për Aleancën e Atlantikut të Veriut. Me këto fjalë, Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka iu drejtua më 28 mars, përfaqësuesve nga vendet anëtare të Aleancës, të ftuar në një mbrëmje gala në Pallatin e Brigadave, që i parapriu disa aktiviteteve që u mbajtën më 29 mars me rastin e 10 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

“10 vjet më parë Shqipëria u pranua si anëtare e Aleancës më të madhe ushtarake që ka njohur ndonjëherë historia. Sot, një dekadë më pas, unë jam shumë krenare që ne, jo vetëm e kemi justifikuar atë besim, por falë punës e kontributit tonë, ia kemi dalë të kthehemi në një partner të besueshëm dhe një aset strategjik për Aleancën në rajon. Një partner që jo vetëm po punon për të përmbushur detyrimet e tij ndaj NATO, por që në këto 10 vite ka treguar vazhdimisht që është i gatshëm dhe i aftë të kompensojë me dedikim dhe profesionalizëm edhe ato që mund të konsiderohen si mungesa a kufizime”, theksoi, gjatë fjalës së mirëseardhjes, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka.

“U deshën vite e dekada të tëra pune për të përmbushur kushtet për anëtarësimin në NATO. Sigurisht që nuk ishte e lehtë, sepse Shqipëria që ëndërroi për herë të parë ëndrrën e anëtarësimit në Aleancë ishte një vend i rrënuar, i sapodalë nga 5 dekada të një regjimi të egër, që në terma vlerash e vizioni për botën e për shoqërinë përfaqësonte antitezën e çdo gjëje që përfaqëson NATO”, - shtoi ministrja Xhaçka.

Duke theksuar se është dashur shumë e shumë punë në këto 10 vjet për të vazhduar transformimin e Forcave të Armatosura, ministrja Xhaçka shtoi se NATO është një aleancë vlerash dhe vendesh që i bashkon, jo vetëm kërkesa për siguri, por edhe besimi tek vlerat e humanizmit, drejtësisë dhe demokracisë.

Ministrja e Mbrojtjes foli edhe për sfidat e së ardhmes, me të cilat përballet sot Aleanca. “Sot jetojmë në një moment ndryshimesh të mëdha historike, që padyshim do të na përballin me shumë sfida e kërcënime ndaj sigurisë. Do të na përballin me nevojën për t’u përshtatur e për të reaguar. Dhe unë nuk kam asnjë dyshim, që ashtu siç ka bërë gjatë 70 vjetëve të ekzistencës së saj, NATO do të dijë sërish të ndryshojë e të përshtatet ndaj çdo krize e çdo kërcënimi. Sepse kjo është një aleancë e ndërtuar jo mbi konvencencën apo frikën e momentit”, - u shpreh më tej ministrja e Mbrojtjes.

Ministrja Xhaçka i adresoi një falënderim të veçantë partnerëve dhe aleatëve strategjikë si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Italisë, Greqisë, Turqisë, por edhe Britanisë së Madhe, Gjermanisë dhe çdo vendi që ka kontribuar në forcimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.



Ministrja e Mbrojtjes e Italisë, Elizabetta Trenta

Siguria e Ballkanit-esenciale për sigurinë e Aleancës

Ceremonitë e ditës së premte, 29 mars 2019, me rastin 10 - Vjetorit të Anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, nisën në “Mak-Albania”, me një konferencë të drejtuar nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e cila falënderoi të gjithë anëtarët e Aleancës për mbështetjen e dhënë si dhe praninë e disa prej tyre në këtë ditë të rëndësishme për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ministrja Xhaçka në fjalën e saj tha se, gjatë këtyre 10 viteve Shqipëria, padyshim e ndihmuar edhe nga statusi i saj si një vend anëtar në NATO, e ka konsoliduar rolin e saj si një shtyllë stabilitetit në rajon.

“Vendimi për të ndërtuar në Shqipëri, në Kuçovë, bazën e parë ajrore në rajonin tonë, padyshim që është një sinjal i fortë i vendosmërisë së Aleancës për të qëndruar në rajon, por edhe një sinjal i fortë i rëndësisë së madhe strategjike që po merr rajoni jonë në raport me garantimin e sigurisë së Europës”, - tha ministrja.

Më tej ministrja Xhaçka shtoi se, sot Ballkani Perëndimor, për



shkak të pozitës së tij gjeografike, por edhe për shkak të historisë është hapësira ku pikëtakohen të gjitha kërcënimet e sfidat e reja. Arsye për të cilën Aleanca duhet të intensifikojë përpjekjet e saj për të stabilizuar rajonin dhe për t’u prerë rrugën tentativave të tilla.

E pranishme në këtë konferencë ministrja e Mbrojtjes së Italisë, Elizabetta Trenta tha se, Ballkani Perëndimor ka një rëndësi të veçantë për Aleancën.

“Siguria e rajonit të Ballkanit është esenciale për sigurinë e Aleancës. Çfarë ndodh këtu na prek të gjithëve.

Rajoni ka bërë shumë punë për të kaluar historinë e të shkuarës dhe herë pas here përballemi me terrorizmin dhe emigrimin. Italia e ka përkrahur gjithmonë Shqipërinë në NATO”, - tha ministrja italiane.

Ndërsa Ministrja e Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut, Radmila Shekerinska, pasi falënderoi, ministren Xhaçka për mbështetjen që Shqipëria i ka dhënë Maqedonisë së Veriut në procesin e anëtarësimit në NATO, theksoi se siguria në rajon është shumë e rëndësishme për të avancuar në Aleancë.

“Ne bëjmë një rrugëtim të jashtëza-

konshëm drejt NATO së bashku dhe rrugët tona u ndanë në vitin 2008 dhe 2019, ne dështuam aty ku ju arritët të kishit sukses. Ne kemi vlerësuar shumë mbështetjen e Shqipërisë për vendin tonë përpara anëtarësimit. Në fillim ne duhet të investojmë në sigurinë tonë rajonale për të investuar më pas në sigurinë atlantike.”, - tha Shekerinska. “Dje, sapo morëm lajmin e mirë nga Uashingtoni pasi dhe Shtëpia e Bardhë ka dërguar propozimin dhe raportin, ndërkohë që mund të fillojë menjëherë në Senatin Amerikan ratifikimi i propozimi. Ndërkohë në vende të tjera ka nisur procedura e ratifikimit. Kjo dëshmon se stabiliteti dhe siguria e Ballkanit jo vetëm është pjesë e axheendës tonë por është dhe pjesë axheendës dhe euro-atlantike. Ky është mesazhi i qartë që të gjithë ne në këtë rajon nuk mund të investojmë për sigurinë euro-atlantike në qoftë se nuk jemi të interesuar të investojmë për sigurinë tonë rajonale”, tha Shekerinska. Më pas të gjithë të ftuarit në këtë konferencë ndoqën pjesën tjetër të aktiviteteve të organizuara me këtë rast.

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Gazetarë:
Saimir **ALIJA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**
Redaktore/Korrektore:
Anila **DODA**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni “Skënderbej”

Shqipëria 10 vjet në NATO

Xhaçka: Anëtarësimi në NATO, më shumë se një çështje sigurie

Festohet 10-Vjetori i Anëtarësimit në NATO. Marrin pjesë Presidenti Meta, Kryeministri Rama, Ministri Xhaçka, shefi i Shtabit të FA Gjeneral brigade Kollçaku, ministrja italiane Trenta, ajo maqedonase Shekerinska, i Kosovës Berisha, etj.

Të premten, më 29 mars 2019, Shqipëria festoi 10-Vjetorin e Anëtarësimit në NATO në një ceremoni në sheshin "Nënë Tereza" në Tiranë, ku morën pjesë presidenti i Republikës dhe Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura Ilir Meta, kryeministri Edi Rama, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, ministrja e Mbrojtjes e Italisë Elisabeta Trenta, ajo e Maqedonisë së Veriut Radmilla Shekerinska, ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës Rustem Berisha. Në këtë ceremoni morën pjesë gjithashtu shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, homologët e tij turk e grek si dhe mjaft të ftuar. Në fjalën përshëndetëse, presidenti i Republikës Ilir Meta, tha se "Shqipëria është e angazhuar që NATO-ja të forcohet më tej si në aspektin politik strategjik, ashtu edhe në atë ushtarak. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO 10 vite më parë përbën një nga ngjarjet më të mëdha në të gjithë historinë e Shqipërisë dhe të kombit shqiptar". Kurse kryeministri Rama tha se "Në 10-vjetorin e anëtarësimit të vendit tonë në NATO, që në fakt përkon me 20-vjetorin e fillimit të një bashkëpunimi të ngushtë gjatë luftës për çlirim të Kosovës, Shqipëria përgatitet të nisë veprën e rëndësishme të ndërtimit të bazës së NATO-s në Kuçovë, e cila do të jetë një prej bazave më moderne dhe më të mëdha të NATO-s në këtë rajon. Ky fakt është simbolikë e bukur e këtij jubileu, sepse baza, e konceptuar si një nga pikat e referimit të aleancave tona strategjike, do të shndërrohet nga një bazë e lindur për t'u mbrojtur nga NATO në një bazë të rilindur të NATO-s".

Më poshtë fjala e plotë e ministres Xhaçka:

Sot mbushen plot 10 vjet nga anëtarësimi i Shqipërisë në NATO. Për ne nuk është thjesht një ditëlindje. Është vërtet një ditë e bukur për t'u festuar, por mbi të gjitha është një ditë kur të gjithë ne kemi të drejtën të ndihemi krenarë!

Ne sot kemi të drejtën të ndihemi krenarë për punën e madhe që u bë për të fituar vendin tonë si anëtar të Aleancës me të madhe ushtarake në histori. Por kemi të drejtën të ndihemi po aq krenarë edhe për punën që kemi bërë të gjithë bashkë në këto 10 vjet për të justifikuar besimin që na u dha, për të modernizuar Forcat tona të Armatosura e për tu kthyer në një faktor stabiliteti dhe një pikë referimi për sigurinë në rajon.

Falë kësaj pune Shqipëria sot nuk është thjesht një vend anëtar i NATO, por një partner i besuar, që siç deklaronte ish - sekretari amerikan i Mbrojtjes, James Mattis, "punches above its weight".

Sot Shqipëria është prova e gjallë që edhe një vend i vogël, me mundësi të kufizuara, mund të kthehet në një aset për një aleancë si NATO. Është ta besonte kush 10 vjet më parë, por sot Shqipëria është një eksportues sigurie, pjesëmarrëse në iniciativat dhe misionet e drejtuara nga NATO në Afganistan, Kosovë dhe detin Egje, në Prezencën e Përparuar të NATO në Letoni. Jemi pjesëmarrës në operacione të drejtuara nga BE



në Bosnje-Hercegovinë dhe Mali ndërkohë që aktualisht po bëhen përgatitjet e fundit për të marrë pjesë në operacionet nën drejtimin e OKB-së në Sudanin e Jugut.

Janë thuhet 5000 djem e vajza të Forcave të Armatosura të angazhuar në misionet e NATO gjatë këtyre viteve. Sot që flasim në operacionet dhe komandat e Aleancës janë të angazhuar 600 ushtarakë çdo vit, çka e bën kontributin tonë ndër më të lartin në raport me përmasat e Forcave të Armatosura!

Ky vit është shumë i rëndësishëm për ne sepse shënon 10 - Vjetorin e Anëtarësimit në NATO, por edhe sepse Shqipëria merr drejtimin e thuhet të gjithë nismave rajonale të Aleancës. Ky kontribut i Shqipërisë si një shtyllë stabiliteti, si një eksportues sigurie dhe partner i përkushtuar ndaj vlerave e misionit të Aleancës është njohur e vlerësuar nga të gjithë aleatët dhe kjo është një arsye e rëndësishme përse në Kuçovë do të fillojë së shpejti puna për investimin më të madh dhe të parën bazë ajrore të NATO në rajonin tonë, një investim që konsolidon rëndësinë e Shqipërisë si një aset strategjik për Aleancën. Kushdo që e njeh Shqipërinë, kushdo që i njeh shqiptaret, e di që ka një arsye shumë të thjeshtë përse ne kontribuojmë me kaq pasion, me kaq vendosmëri e energji, për të përmbushur detyrimet tona si anëtarë të NATO.

Për shumëkënd, NATO është mbi të gjitha një organizatë e fokusuar tek mbrojtja kolektive, tek bashkëpunimi ushtarak, tek përpjekja për të gjetur siguri. PO! Për shqiptarët NATO është Aleanca që i solli lirinë shqiptarëve në Kosovë 20 vjet më parë. Megjithatë për ne anëtarësimi në NATO ka qenë dhe mbetet shumë më tepër sesa thjesht një çështje sigurie. Sepse për shqiptaret

anëtarësimi në NATO ishte mbi të gjitha një certifikim i vokacionit të tyre evropian dhe perëndimor. Ishte një rikthim në shtëpi, në familjen e madhe të kombeve evropiane e perëndimore, në familjen e shteteve demokratike.

Vite më parë, përpara se Shqipëria të bëhej anëtarë e Aleancës, më kujtohet që kur diskutohet mbi mbështetjen e madhe të shqiptarëve për anëtarësimin në NATO, e cila, edhe në rastin më të keq, arrinte në mbi 90%, kishte shumë nga ata që thoshin se shqiptarët nuk e kuptonin mirë se anëtarësimi kishte anëtarë e tij



pozitive, por që kishte edhe kostot e veta. Që Shqipëria nuk ishte gati dhe shqiptarët e kishin kuptuar anëtarësimin në NATO thuhet si një formulë magjike për të përfituar nga pjesëmarrja në Aleancë pa u dashur të bënin edhe detyrat e tyre.

Janë argumente që i dëgjojmë edhe sot. Është një skepticizëm që e hasim edhe sot kur gjendemi në një moment kyç në procesin e integritimit në Bashkimin Europian. Unë besoj

që skeptiket gabohen sot, ashtu siç gaboheshin dhe atëherë dhe prova më e gjallë që gabohen është ajo që ka ndodhur pas anëtarësimit tonë në NATO. Shqiptarët ishin shumë të vetëdijshëm për punën dhe sfidat që i prisnin. Ne të gjithë ishim shumë të vetëdijshëm që anëtarësimi shënonte përmbushjen e një objekti madhor strategjik, i një objekti, që bashkë me anëtarësimin në BE, përbente boshtin strategjik të politikës së jashtme shqiptare të pas komunizmit. Anëtarësimi ishte jo fundi, por fillimi i një pune shumë të madhe në çdo fushë



të jetës së vendit. Në fushën e Mbrojtjes e Sigurisë, padyshim, por edhe për modernizimin e vendit, për zhvillimin dhe evropianizimin e tij, për vendosjen e sundimit të ligjit. Sepse, siç e theksova, për ne, anëtarësimi në NATO, ishte mbi të gjitha anëtarësim në një familje që ndan të njëjtat vlera, të njëjtin vizion për shtetin e shoqërinë.

Unë s' kam asnjë dyshim, që ne do të vazhdojmë të punojmë

me të njëjtin përkushtim edhe për t'u përballur me sfidat e integritimit në Bashkimin Europian dhe besoj që ashtu siç e provuam që skeptiket gaboheshin lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, ashtu do të dimë t'u provojmë që gabohen edhe lidhur me gatishmërinë dhe vullnetin e Shqipërisë për të përmbushur çdo detyrim në lidhje me integritimin evropian.

Dhe ashtu siç ia dolëm të kthehemi në një histori suksesi e një partner të besueshëm e faktor stabiliteti për Aleancën, do të dimë të kthehemi në një partner e aset edhe për Bashkimin Europian.

Dhe së fundmi, disa vjet nga sot, kur Shqipëria të festojë një tjetër përvjetor të anëtarësimit, pavarësisht kush do të jetë në këto detyra, jam e bindur se të gjithë bashkë do t'ia kemi dalë jo vetëm të realizojmë shumë nga ato objektiva për të cilët po punojmë sot, por do t'ia kemi dalë t'u provojmë të gjithë skeptikeve që e kanë gabim dhe t'u provojmë të gjithë miqve e mbështetësve atë që ata tashme e dinë: Vullnetin e shqiptarëve për të evropianizuar e modernizuar vendin e tyre, vullnetin për t'u rikthyer në familjen evropiane, në familjen e shteteve demokratike ku e kemi vendin.

Sot dua t'iu them nga zemra faleminderit gjithsecilit prej jush që kontribuon për realizimin e këtij qëllimi strategjik të shqiptarëve. Partnerëve tanë strategjike për mbështetjen e pamatë për edukimin, trajnimin dhe modernizimin e forcës sonë, por edhe çdo ushtaraku për punën e palodhur dhe veçanërisht familjeve tuaja që ju kanë sakrifikuar e ju kanë mbështetur me gjithë vështirësitë, nevojat ende të paplotësuara apo mungesat e gjata.

Nga zemra gjithsecilit faleminderit për shërbimin e kontributin tuaj!

SHQIPËRIA 10 VJET NË NATO

Greçia ka kontribut në anëtarësimin e Shqipërisë në NATO

Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, priti shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA të Greqisë gjeneral Christos Christodoulou

Në kuadër të 10-vjetorit të anëtarësimin të Shqipërisë në NATO, si dhe me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të Greqisë gjeneral Christos Christodoulou. Pas ceremonisë së pritjes, gjeneral Christodoulou zhvilloi më 29 mars një takim të veçantë me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.

Gjeneral brigade Kollçaku pasi ka vlerësuar bashkëpunimin mes dy vendeve, u shpreh se Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe Greqisë kanë një histori të pasur bashkëpunimi reciprok në fusha të ndryshme si

në fushën e edukimit, trajnimit, stërvitjes, emergjencave civile si dhe në mbështetjen mjekësore, etj.

Gjatë takimit, gjeneral brigade Kollçaku ka vlerësuar rolin dhe kontributin që qeveria greke dhe FA të Greqisë kanë dhënë në rrugën e anëtarësimin të Shqipërisë në NATO. Nga ana e tij Gjeneral Christodoulou falënderoi gjeneral brigade Kollçakun për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes si dhe shprehu vullnetin për ta vijuar dhe zgjeruar edhe më tej në të ardhmen. Gjatë takimit të dy bashkëbiseduesit shprehën besimin dhe dëshirën e vijimit dhe forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve edhe në të ardhmen.



Gjeneral brigade Kollçaku-gjeneral brigade Maiocco

FA në stërvitjet të drejtuara nga SHBA dhe NATO

Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku priti Komandantin e Mbështetjes së Misioneve në Komandën e Bashkuar Amerikane në Europë, gjeneral brigade Frederick Maiocco

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku priti më 29 mars, në një takim pune Komandantin e Mbështetjes së Misioneve në Komandën e Bashkuar Amerikane në Europë, gjeneral brigade Frederick Maiocco, i cili zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë në kuadër të 10 vjetorit të anëtarësimin të Shqipërisë në NATO.

Gjeneral Kollçaku pasi vlerësoi bashkëpunimin e sukseshëm në fushën e mbrojtjes mes FA shqiptare dhe atyre të SHBA dhe kryesisht në drejtim të rritjes së kapaciteteve ushtarake të FARSH dhe rolit të tyre në kompletimin e grup batalionit të këmbësorisë dhe certifikimin "Full Combat Ready". Kompletimi me automjete të blinduara HMMWV dhe MRAP, EOD me kapacitete speciale operacionale, si dhe programet e vazhdueshme të ndihmës në fushën e arsimimit, stërvitjes dhe trajnimit, janë vijimësi e këtij bashkëpunimi në modernizimin e Forcave të Armatosura shqiptare.

Të dy bashkëbiseduesit shprehën gatishmërinë se bashkëpunim ushtarak në fushën e mbrojtjes do të vijojë të njohë rritje edhe në të ardhmen dhe FA shqiptare do të vijojë të mbështesë stërvitjet e mëdha ndërkombëtare të udhëhequra nga SHBA dhe NATO, ku Shqipëria do të jetë vendi pritës në rajon.



Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku në Romë, Itali

Ngrihet Qendra e Ekselencës e Ndihmës dhe Forcës së Sigurisë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku mori pjesë më 27 mars, në ceremoninë e inaugurimit të Qendrës së Ekselencës së Ndihmës së Forcës së Sigurisë, (NATO SFA COE) në Romë, Itali.

Në përshëndetjen e tij në këtë ceremoni të veçantë, gjeneral brigade Kollçaku pasi falënderoi gjeneral Vecciarelli, gjeneral brigade Glavaš, ambasadorët, drejtorin e kësaj qendre, kolonel Merlino, etj, të cilët me punën dhe përkushtimin e tyre e bënë realitet ngritjen e Qendrës së Ekselencës për Asistencë të Forcës së Sigurisë së NATO, NATO Security Force Assistance Centre Of Excellence, (NATO SFA COE), u shpreh se ndihej i nderuar që merrte pjesë në ceremoninë e inaugurimit të saj. "NATO SFA COE, është struktura më e re e akredituar nga NATO dhe e 25-ta në rrjetin e qendrave të ekselencës të krijuara në vende të ndryshme anëtare të Aleancës dhe krijimi i saj erdhi si domosdoshmëri në mbështetje të Konceptit të ri Strategjik të Aleancës. Për vendin tim, Shqipërinë, kjo ceremoni e hapjes është me rëndësi të madhe, si një komb që investoi për ngritjen e saj..." - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigade Kollçaku.



Më tej gjatë fjalës së tij, gjeneral brigade duke u ndalur në rrugëtimin e Shqipërisë për t'u integruar në organizatat Euroatlantike të Sigurisë, theksoi se Shqipëria ka një progres të kontributeve në misionet e NATO dhe pas disa ditësh Shqipëria feston 10 - Vjetorin e Anëtarësimin të saj të plotë në NATO. "Vendi ynë ka

zgjeruar jo vetëm gjeografikisht kontributet e veta, por edhe me kapacitete gjithnjë e më rritje si në numër ashtu edhe në cilësinë e këtyre trupave, veçanërisht në misionin e EOD, Grup-batalionit në Letoni si dhe forcat speciale në Afganistan..."

Në përfundim të përshëndetjes së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku u shpreh se: "Vendi ynë është shumë krenar për mbështetjen e iniciativës italiane, një vendi që krenohet me një bashkëpunim të gjatë dhe një miqësie të madhe me Shqipërinë, veçanërisht në mbështetjen që na ka dhënë në kohët e vështirësive të së kaluarës dhe në zhvillimet e sotme për të ardhmen euroatlantike të vendit tonë. Është koha t'ju siguroj mbështetjen time të plotë për të nxitur bashkëpunimin tonë në fushën e mbrojtjes edhe në të ardhmen..."

Qendra e Ekselencës "NATO SFA COE", është struktura më e re e akredituar nga NATO dhe e 25-ta në rrjetin e qendrave të ekselencës të krijuara në vende të ndryshme anëtare të Aleancës. Shqipëria është shteti i parë që mbështeti fuqishëm iniciativën italiane dhe së bashku me Slloveninë arriti të jetë një nga nënshkruesit e parë të Memorandumeve të Mirëkuptimit më 13 dhjetor 2017, duke bërë të mundur që të konvergojnë interesat kombëtare në një drejtim me ato të Aleancës dhe të ndërmarrin një linjë të përbashkët veprimi.

Bashkëpunimi me Turqinë do vijojë edhe në të ardhmen

Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, priti Shefin e Shtabit të Përgjithshëm FA të Turqisë, Gjeneral Yasar Guler dhe zv.komandantin e Forcave Detare të Gjermanisë, Kundër Admiral Jurgen zur Muhlen

Në kuadër të 10-vjetorit të anëtarësimin të Shqipërisë në NATO si dhe me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, po zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm FA të Turqisë, Gjeneral Yasar Guler. Pas ceremonisë së pritjes, Gjeneral Guler u prit më 28 mars, në një takim të veçantë nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku. Gjeneral brigade Kollçaku ka falënderuar Gjeneral Guler për mbështetjen e gjithanshme të FA turke për transformimin dhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura në fusha të ndryshme, si arsimimi, stërvitja, logjistika, etj. Të dy ushtarakët e lartë vlerësuan gjithashtu angazhimet e përbashkëta në kuadër të NATO në Afganistan, si dhe shprehën bindjen se ky bashkëpunim do të vijojë edhe në të ardhmen, jo vetëm si dy vende dhe popuj miq, por edhe si anëtarë të Aleancës Euroatlantike.



Më herët, gjeneral brigade Kollçaku priti zv.komandantin e Forcave Detare të Gjermanisë, Kundër Admiral Jurgen zur Muhlen, i cili ndodhet në vendin tonë me ftesë të tij si dhe në kuadër të 10-vjetorit të anëtarësimin të Shqipërisë në NATO. Kundër admiral Muhlen vlerësoi bashkëpunimin mes dy forcave të armatosura, si dhe në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Gjermanisë ad-

resoi një falënderim të veçantë për qeverinë shqiptare dhe FARSH për kontributin e shquar në Detin Egje që në nëntor 2016. Nga ana e tij, gjeneral brigade Kollçaku pasi shprehu një falënderim të veçantë për ndihmën që Gjermania ka dhënë, sidomos në ofrimin e bursës në Akademinë e Drejtimit, në Gjermani pas kaq viteve ndërprerje, kthehet sërish, ku FARSH do të dërgojë ushtarakë për të studiuar në këtë akademi.

Komanda e Aleancës për Transformim

Admiral Nielson vlerëson kontributin e Shqipërisë në NATO

Gjatë vizitës së tij, admirali Nielson mbajti dhe një leksion për personelin e FARSH me temë "ACT as Warfare Development Command and future threats from an ACT perspective"

Në kuadër të 10-Vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe me ftesë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku zhvilloi një vizitë në vendin tonë zëvendës komandanti i Komandës së Aleancës për transformim, admiral Manfred Nielson. Pas ceremonisë së pritjes, admiral Nielson zhvilloi takime me ministren e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku.

Gjatë takimit në Shtabin e Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Kollçaku vuri theksin në rolin tepër të rëndësishëm të Komandës së Aleancës për Transformim si motori i zhvillimit të kapaciteteve dhe mendimit strategjik të Aleancës. Gjithashtu, gjeneral brigade Kollçaku gjatë takimit vlerësoi rolin e kësaj komande në procesin e integritetit të plotë të Shqipërisë në NATO, i cili përfundoi në 13 tetor 2013, 4 vjet pas anëtarësimit. Nga ana e tij, admiral Nielson pasi vlerësoi kontributin e Shqipërisë në NATO, si dhe njohu përpjekjet e saj për plotësimin e kapaciteteve të kërkuara nga paketa e objektivave të kapaciteteve, ai bëri një rezumë të drejtimeve kryesore të punës aktuale që po bëhet nga kjo komandë në vitin në vijim si dhe ob-



jektivat për të ardhmen. Gjatë vizitës së tij, admirali Nielson mbajti dhe një leksion për personelin e FARSH me temë "ACT as Warfare Development Command and future threats

from an ACT perspective", ku sfidat, perspektivat si dhe qasja që NATO ka aktualisht, si një ndër organizatat më të mëdha dhe të rëndësishme në botë, ishin kryefjala e kësaj ligjërate.



10-VJETORI I HYRJES SË SHQIPËRISË NË NATO

"Dita e Hapur" e Forcës Detare në Portin e Vlorës

Në Portin e Vlorës u organizua aktiviteti "Dita e Hapur" e Forcës Detare në kuadër të 10-Vjetorit të hyrjes së Shqipërisë në NATO dhe 61-vjetorit të krijimit të Anijeve Mbiujëse të Forcës detare. I pranishëm në aktivitet ishte shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, cili është shprehur se kjo ditë ka dy simbolika, mbas disa ditësh Shqipëria, por edhe Forcat Detare do të festojnë 10-Vjetorin e hyrjes së

Shqipërisë në NATO, si dhe 61-Vjetorin e krijimit të Anijeve Mbiujëse të Forcës Detare. Sot personel i Forcës Detare shërben në strukturat e NATO, por kontributi më i madh i tyre është pjesëmarrja, me një anije të klasit Iliria, si këto të dyja që do vizitoni, në operacionin NATO në detin Egje.

Takimi i tre brezave: ish-ushtarake, ushtarakë në detyrë dhe përfaqësues të brezit të ri është diçka shumë e veçantë, pasi janë të pranishëm tre breza dhe të rinjtë e shkollave të

mesme të Vlorës i japin shumë gjallëri kësaj dite. Zëvendëskomandanti i Forcës Detare kapiten i Rangut I Artur Meçollari dha një certifikatë mirënjohje për zotin Tetem Mamutaj në 80-vjetorin e tij të lindjes, veteran, ish-pedagog në Akademinë e Detarisë dhe një nga specialistët e armëve të nënujshme të Forcës Detare. Më pas, ish-ushtarakët, qytetarë të ndryshëm dhe nxënës vizituan anijet "Oriku" dhe "Lissus" që shërbejnë në detin Egje.

AKTIVITETI

Zhvillohet vrapimi "10 vjet në NATO"

Me iniciativën e zëvendës shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, në kuadrin e festimit të 10 vjetorit të hyrjes së Shqipërisë në NATO, në datën 25 mars 2019, u zhvillua vrapimi disa kilometrash në natyrë. Në këtë vrapim vullnetar morën pjesë edhe vetë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, zëvendës shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, si dhe personel ushtarak e civil nga Shtabi i Përgjithshëm i FA dhe strukturave të tjera të vendosura në Garnizonin "Skënderbej".

Qëllimi i këtij aktiviteti nuk ishte konkurrues apo për vende nderi, por për të transmetuar mesazhet e unitetit dhe të bashkimit, të solidaritetit e të bashkëpunimit ndërmjet brezave, gradave, moshave dhe genderit. Aktivitetet sportive në Forcat e Armatosura janë pjesë e veprimtarive të përditshme në çdo njësi dhe repart, duke patur parasysh faktin se të qënurit pjesë e NATO-s përveç përgatitjes profesionale dhe plotësimin të standardeve të larta në aspektin ushtarak, kërkon edhe përgatitje të lartë fizike, e cila arrihet me punë e djersë në stërvitje, por edhe në kohën e lirë. Vrapimi u krye në një kohë të bukur pranverore me masa të mira organizuese, ku ra në sy uniforma sportive me logon kuptimplotë në bluzën e secilit "10 vjet në NATO". Ky aktivitet i priu aktiviteteve të shumta që Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm ka zhvilluar gjatë kësaj jave në kuadrin e 10 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, të cilat kulmuar me veprimtarinë kryesore në Sheshin "Nënë Tereza" në datën 29 mars 2019, si dhe me maratonën "NATO TIRANA RUN", që do zhvillohet në datën 6 prill 2019, ora 10:00 në Parkun e Madh pranë Liqenit Artificial të Tiranës, organizuar nga "Yourth Atlantic Treaty Association of Albania", veprimtari edhe kjo në kuadrin e 10 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, ku parashikohen të marrin pjesë mjaft ushtarakë të Forcave të Armatosura.



Organizuar nga ambasada holandeze

Seminar rajonal "Gratë në Forcat e Armatosura"

Nga data 26-28 mars 2019 nën drejtimin e Ambasadës Holandeze në Tiranë, u zhvillua seminari "Gratë në Forcat e Armatosura", me pjesëmarrje nga përfaqësues të vendeve të rajonit si Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi. Në këtë aktivitet nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë morën pjesë Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, si dhe pesë përfaqësues të strukturave të Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes që kanë si objekt të punës së tyre problemet e barazisë gjinore. Aktiviteti ka trajtuar në mënyrë të veçantë rëndësinë dhe rolin e pjesëmarrjes së femrave në operacione paqebërëse, paqeruajtëseapo humanitare. Gjatëtriditëve të seminarit, pjesëmarrësit u njohën me përcaktimet dhe definicionet e politikës "Gender", rregullat dhe politikat e aplikueshme në rastet e dislokimit të personelit femër në këto misione. Më tej të pranishmit u njohën nga afër me fakte dhe eksperiencën nga ushtarakët të FA që kanë marrë pjesë në misione ndërkombëtare në kuadër të NATO, OKB dhe BE. Gjenerale Shehu për shkak të angazhimeve të tjera zyrtare jashtë vendit, mori pjesë vetëm në çeljen e këtij seminari në datën 26 Mars. Prezantimin në emër të Gjeneral Shehut gjatë aktivitetit e ka mbajtur Nënkolonel Alda Sula, Shefe BCU në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes.

Shqipëria-10 vjet në NATO

Samitit të Strasburgut i parapriu Samiti i Bukureshtit



NGA DASHNOR DERVISHI
Ish ambasador Fuqplotë
i Shqipërisë në Rumani

Me rastin e 10-vjetorit të anëtarësimit të vendit tonë në NATO, viti 2019 është shpallur nga qeveria shqiptare si Viti i NATO-s. Por akti zyrtar, më 2 prill 2009, në Samitin e Strasburgut, për finalizimin e aspiratës së Shqipërisë për t'u bërë anëtare e NATO-s me të drejta të plota, i parapriu Samiti i Bukureshtit, një vit më parë, më 2 prill 2008, ku Shqipëria mori ftesën e anëtarësimit për në NATO. Ambasadori Dashnor Dervishi, në shënimet e tij lidhur me zhvillimet e atij Samiti, sjell disa nga momentet interesante të atyre ditëve në Bukuresht.

Mbajtja e Samitit të NATO-s në Bukuresht, nga 2 deri 4 prill 2008, ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme jo vetëm për Rumaninë, por edhe në shkallë botërore; në mënyrë të veçantë, ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme edhe për vendin tonë dhe për rajonin e Europës Juglindore. Duke u ndodhur në Rumani, si ambasador i vendit tim, pa dyshim që ishte një ngjarje dhe eksperiencë e veçantë edhe për mua, edhe stafin e ambasadës në Bukuresht.

Samiti i NATO-s filloi dhe mbaroi brenda tri ditëve, por përgatitjet, zhvillimi dhe ndikimi i tij do të shtriheshin shumë më gjatë në kohë, si para, ashtu edhe me efektet pas tij. Shënimet për këtë ngjarje pasqyrojnë vetëm atë pjesë të dukshme të perceptimeve nga vendi ku do të zhvillohej Samiti, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në Bukuresht; ato nuk marrin përsipër të tregojnë politikën e madhe, që luhej midis fuqive të mëdha apo konjunkturave në Bruksel, ku ndodhej Selia e NATO-s.

Samiti i NATO-s, i mbajtur në Bukuresht, ishte mjaft i rëndësishëm në mënyrë të veçantë për Rumaninë, pasi e vuri atë për disa ditë në epiqendër të vëmendjes së opinionit publik në botë. Në fillim të muajit mars, një muaj para Samitit, në Bukuresht vjen për një vizitë zyrtare ministri i Mbrojtjes së vendit tonë, Fatmir Mediu, i ftuar nga homologu i tij rumun, Teodor Melescanu. Gjatë qëndrimit në Rumani u bënë shumë takime e vizita në disa reparte dhe qendra të rëndësishme të ushtrisë rumune. Në bisedimet zyrtare, por edhe gjatë gjithë takimeve të tjera, delegacioni shqiptar mori konfirmimin e plotë nga pala rumune, se në samitin e ardhshëm Shqipëria do të merrte ftesën e anëtarësimit. Për ne, konfirmimi dhe gjithë informacionet që merrnim nga pala rumune, lexoheshin si pasqyrim i mendimit dhe qëndrimit të vendeve të tjera të rëndësishme të NATO-s, pasi informacioni që vinte nga Rumania ishte në një masë më të lartë besueshmërie si vend organizator.

"Samiti i Bukureshtit do të jetë samiti i zgjerimit dhe ne mirëpresim vendet e Kartës së Adriatikut. Shqipëria ka mbështetjen e plotë të Rumanisë jo vetëm për marrjen e ftesës, por dhe për procesin e mëtejshëm të anëtarësimit të plotë", konfirmoi ministri i Mbrojtjes i Rumanisë, Teodor Melescanu. Të dy ministrat ranë dakord që niveli i bashkëpunimit midis Forcave tona të Armatosura të rritej më tej, në mënyrë të veçantë në misionet e përbashkëta në vendet me konflikte. Delegacioni pati takime edhe me Presidentin e Dhomës



së Deputetëve, Bogdan Olteanu, dhe me kryetarin e Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, Kostika Canacheu, ku mori mbështetje jo vetëm për marrjen e ftesës për anëtarësim, por dhe për hapat e mëtejshëm të ratifikimit të plotë të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO nga Parlamenti rumun.

Për nder të delegacionit të nivelit të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, organizova një drekë ku morën pjesë zyrtarë të lartë nga Presidencia, Parlamenti, Ministria e Jashtme dhe ajo e Mbrojtjes. Gjatë ditëve të qëndrimit në Bukuresht të ministrit tonë të Mbrojtjes, u dhanë shenjat e para të një debati të pritshëm, lidhur me kapacitetet e rezervave të armatimit dhe municioneve ushtarake në Shqipëri, të mbetura që nga Lufta e Ftohtë para viteve '90. Pikërisht ato ditë, u bë i njohur edhe problemi i angazhimeve të vendit tonë për pakësimin e armatimeve dhe demontimin e municioneve, që për qeveritarët tanë krijonte mundësira të mëdha për t'u përfshirë në trafiket ndërkombëtare dhe korrupsion. Një bisedë e gjatë telefonike e korrespondentit e "New York Times" me ministrin tonë ishte sinjali që i parapriu skandalit, i cili pritej të shpërthente me trafikun e armëve dhe municioneve.

Më 14 mars, në kuadër të një seminary ndërkombëtar të organizuar nga NATO, Ilir Kulla, këshilltar në Presidencë, mori takim me homologët e tij rumunë. Gjatë bisedave, u trajtuan problemet e sigurisë në të dy vendet tona, u shkëmbyen eksperiencat në kuadër të reformave të ndërmarra, si dhe u shpreh angazhimi për një bashkëpunim më të ngushtë midis institucioneve të sigurisë. Të nesërmen, rreth mesditës, telefonata të shumta na vijnë nga Tirana, lidhur me shpërthimin e saponododhur në Gërdec, në depon e demontimit të municioneve ushtarake. Një shqetësim i madh na pushtoi jo vetëm për fatkeqësinë e ndodhur në afërsi të Tiranës, por duke qenë në Bukuresht, në prag të samitit të NATO-s, dilema e parë që na lindi ishte se çfarë do bëhej me ne, lidhur me anëtarësimin. Dy ishin alternativat: ose çdo gjë do të anulohet, pasi aleatët do të shikonin te Shqipëria një vend të paafhtë, të korruptuar e të pabesueshëm, ose anëtarësimi do të bëhej më i sigurt, pasi lënia jashtë e Shqipërisë do të paraqiste rrezikshmëri më të lartë, si për vendin, ashtu edhe për rajonin, për vetë faktet e mësipërme. Në fakt, predominoi e dyta.

Kjo gjë u vu re që në reagimet e

para, si në kontaktet me zyrtarët rumunë, nga jehona në shtypin vendës, ashtu edhe nga bisedat në takimet me Trupin Diplomatik. Ngjarja shihej si një aksident tragjik, në kuadrin e përpjekjeve që po bënte ushtria shqiptare për t'u përafëruar parametrevë të NATO-s, nëpërmjet demontimit të municioneve të tepërta. Asnjë fjalë, që mund të vinte në dyshim marrjen e ftesës në Samit. Ndryshe nga herë të tjera, shtypi i orientuar rumun nuk i la shumë vend debatit të brendshëm, që shpërtheu në luftën dhe akuzat midis partive politike në Shqipëri për atë tragjedi, duke e lidhur atë me afëra korruptive.

Në javën e fundit të muajit mars, revista mujore "Ballkani dhe Europa" botoi një intervistë të tamen. Flitej për disa arritje të vendit tonë në aspekte të ndryshme, duke argumentuar në mënyrë të veçantë rolin e Shqipërisë dhe Forcave të saj të Armatosura, si një faktor që jepte kontributin e saj për paqen dhe sigurinë në rajonin tonë dhe në disa vende në krizë, krahas forcave të NATO-s, në kuadër të ISAF. Vlerësohej gjithashtu mbështetja e Rumanisë për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe veçanërisht për tri vendet e A-3 në këtë proces integrimi, në mënyrë bilaterale dhe shumëpalëshe.

Deri më 24 mars, nga Komiteti Organizator në Bukuresht ende nuk po na jepej programi përfundimtar i Samitit. Megjithatë ata e kishin një draft pothuajse përfundimtar, nuk ishin të autorizuar ta shpërndanin në Bukuresht, por vetëm nëpërmjet misionëve në Bruksel. Ishte ambasadori i Kroacisë, që na njohu me draftprogramin e Samitit. MPJ e vendit të tij, i a kishte përcjellë programin, që kishte marrë nga Misioni i tyre në Bruksel në rrugë të rezervuar. Samiti i Bukureshtit ishte më i madhi nga të gjitha samitet e organizuara nga NATO më parë, si nga pikëpamja organizative dhe e pjesëmarrjes së gjerë, ashtu edhe nga tematikat, larmia e debateve dhe vendimeve që u morën.

Atmosfera e punimeve të Samitit ishte ekstremisht solemne nga të gjitha pikëpamjet, si nga rëndësia e sallës kryesore ku u zhvilluan seancat plenare, ashtu edhe nga prania e udhëheqësve më të rëndësishëm të planetit tonë. Në Samit ishin të pranishëm kryetarët e shteteve, kryeministrat, ministrat e Mbrojtjes dhe ata të Jashtëm, së bashku me delegacionet që shoqëronin nga 26 vende anëtare të NATO-s; kryetarët e shteteve nga 23 vende partnere, në kuadrin e Këshillit të

Partnershipit Euroatlantik, nga Europa Lindore, Azia Qendrore dhe Ballkani Perëndimor, përfshirë edhe Japoninë dhe Australinë. Ishin ftuar Presidenti i Gjeorgjisë, Mikhail Saakashvili, dhe i Ukrainës, Victor Jushchenko; Presidenti i Iranit, Hamid Karzai; Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin. Në Samit morën akreditimin rreth 3.500 gazetarë, më shumë se 200 fotoreporterë dhe kameramanë. 12 mijë oficerë Policie dhe xhandarë u vendosën me shërbim në Bukuresht. 6 avionë luftarakë Shqiptarë F-15 u vendosën në bazën ushtarake të Campia Turzii, në mbështetje dhe për shoqërimin e avionëve qeveritarë. Në prag të Samitit u organizuan manovra ushtarake në Detin e Zi dhe u morën masa të larta sigurie të kontrollit të rrugës nga Konstanca në Bukuresht. Gjatë një jave, trafiku i Bukureshtit u bllokua plotësisht, duke mbajtur hapur vetëm korridoret për automjetet e delegacioneve. Lëvizjet bëheshin vetëm me autobusë për anëtarët e delegacioneve, përveç kryetarëve të shteteve që lëviznin me vetura.

Në një intervistë Presidenti i Rumanisë, Basescu, shprehu habinë për praninë e madhe të gazetarëve në Samit, 3500 gazetarë të akredituar. Ai vuri në dukje interesin e madh që kishin gazetarët për axhendën e Samitit dhe faktin se 50 vjet më parë asnjë njeri nuk e imagjinonte dot se Rumania do të ishte mikpritëse e Samitit të NATO-s. Të dy i kërkuan falje popullit të Bukureshtit për vështirësitë që do t'u krijoheshin ato ditë, për shkak të kufizimeve të trafikut. Më 1 prill do të zbrisnin në aeroportin e Bukureshtit avionët qeveritarë të Kryeministrit të Kanadasë, Stephen Harper; të Presidentit të Gjeorgjisë, Mikhail Saakashvili; të Presidentit të Afganistanit, Hamid Karzai; të Sekretarit të Përgjithshëm të NATOs, Jaapde Hoop Scheffer. Presidenti i Francës, Nicolas Sarkozy; Kryeministri i Britanisë së Madhe, Gordon Brown; Kancelarja gjermane, Angela Merkel, dhe Sekretari i Përgjithshëm i OKB, Ban Ki-Moon mbërritën më 2 prill.

Presidenti i SHBA, George W. Bush, mbërriti në aeroportin e Bukureshtit ditën e mërkurë, datë 1 prill. Delegacioni amerikan përbëhej nga 180 anëtarë. Vetëm në aeroport ishin të pranishëm rreth 30 ushtarë për sigurinë e Presidentit amerikan. Kjo ishte vizita e dytë e Presidentit Bush në Bukuresht qysh nga vjeshta e vitit 2002, mbas Samitit të Pragës, kur Rumania mori ftesën për në NATO. Të martën, më 30 mars, përpara se të mbërrinte në Bukuresht, Presidenti amerikan Bush qëndroi një natë në Kiev, prej nga deklaroi se SHBA do të mbështeste fort Ukrainën dhe Gjeorgjinë për anëtarësimin në Planin e Veprimit (MAP), gjë që do të ishte një nga qëllimet e rëndësishme të Samitit të Bukureshtit. Ndaj këtij synimi kishte rreth 10 vende që ishin kundër, ndër të cilat edhe Franca, Gjermania etj. Pasi bëri një vizitë të shkurtër në bazën amerikane në Mihail Kogalniceanu, Bushi së bashku me Basescun morën pjesë në Forumin Transatlantik, ku mbajtën nga një diskutim të shkurtër lidhur me axhendën dhe objektivat e Samitit: zgjerimi i aleancës me Shqipërinë, Kroacinë dhe ndoshta edhe Maqedoninë, si

dhe përfshirjen në MAP të Ukrainës dhe Gjeorgjisë. Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, mbërriti në Bukuresht për të marrë pjesë në takimin NATO-Rusi, ditën e fundit, pa praninë e gazetarëve. Me mbarimin e punimeve të Samitit, Bush dhe Putin do të niseshin për në qytetin e vogël rus të Sotchit, në bregun e Detit të Zi për t'u takuar edhe një herë së bashku. Së bashku me stafin e ambasadës, më 1 prill kishim dalë edhe ne në aeroport për të pritë Presidentin Topi, Kryeministrin Berisha, ministrin e Jashtëm Basha dhe atë të Mbrojtjes Oketa, si dhe një grup deputetësh nga partitë parlamentare, gazetarë, etj; gjithsej rreth 50 vetë. Kaluam pothuajse gjithë ditën në aeroport, pasi përfaqësuesit nga Tirana kishin zgjedhur linja të ndryshme për të mbërritur në Bukuresht, me avionë që mbërrinin në orë të ndryshme. Gjatë pritjes në aeroport, ishim të detyruar të mos kishim asnjë komunikim me celular, pasi gjatë uljes së avionëve të rëndësishëm, valët e shërbimit telefonik me celularë ishin të ndërprera.

Siç ishte bërë e ditur që më parë, temat kryesore të Samitit të NATO-s në Bukuresht ishin ato të zgjerimit, partneritetit me Rusinë dhe vendet e tjera të Lindjes, siguria në rajonin e Detit të Zi, mbështetja për vendet që ishin në ballë të luftës kundër terrorizmit etj. Rumania mbështeti me forcë zgjerimin, që ishte edhe tema më e rëndësishme e Samitit, jo vetëm për tri vendet e Ballkanit, por edhe për Ukrainën dhe Gjeorgjinë. Kjo gjë ishte pjesë e strategjisë së saj, për interesat kombëtare, për të mos mbetur një vend në kufi të Aleancës. Të njëjtën mbështetje dha edhe për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, në mënyrë të veçantë për Serbinë. Në një intervistë të gjatë në TV, të hënë në darkë, më 29 mars, Presidenti Basescu, ndër të tjera, theksoi se Lufta e Ftohtë tashmë kishte mbaruar dhe Rusia nuk kishte pse të trembej nga afrimi i Ukrainës dhe Gjeorgjisë me aleancën perëndimore. Ndaj Rusisë nuk ka asnjë vend anëtar të NATO-s që mund ta sulmojë, ndërkohë që të gjithë së bashku kemi të përbashkët luftën kundër terrorizmit. Ai iu drejtua direkt Presidentit rus Putin, duke i bërë thirrje që të vinte në Bukuresht dhe të bëhej partner i tyre. Më tej, Basescu përmendi se tri objektivat më të rëndësishme të Samitit do të ishin zgjerimi i NATO-s, gjendja në Afganistan dhe Ballkanin Perëndimor, si dhe mbrojtja kundër kërcënimeve të shekullit të XXI. Pasi deklaroi se përveç ftesës që do t'i bëhej Shqipërisë, Kroacisë dhe Maqedonisë si dhe afrimit në MAP të Ukrainës dhe Gjeorgjisë, ai bëri thirrje për nevojën e një zgjidhjeje globale për rajonin. Në këtë kuadër, ai shtoi se Bosnje-Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia nevojitej që të përafëronin marrëdhëniet e tyre respektive me Aleancën në Bukuresht. Gjatë një interviste të mëparshme në prag të Samitit të NATO-s, Basescu kishte bërë thirrje edhe për nevojën, që NATO, si një organizatë ushtarake, duhej të garantonte infrastrukturën e transportit të energjisë në Europë, duke përfshirë edhe Rumaninë si një furnizuese e rëndësishme, e aftë të mirëpriste një ngjarje të rëndësishme të NATO-s në Bukuresht.

70 vjetori i NATO-s dhe 10-vjetori i anëtarësimit të Shqipërisë

SHBA: Roli i Shqipërisë në Aleancë,
shembull për vendet aleate

E ngarkuara me punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, Leyla Moses-Ones, mori pjesë më 21 mars 2019, në një event të mbajtur në Tiranë me rastin 70-të vjetorit të NATO-s dhe 10-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në aleancën më të madhe ushtarake në botë, NATO. “Shqipëria ka dhënë kontributin e saj të vyer në aleancën ushtarake. Sigurisht që mbetet një shembull për t’u marrë nga të gjithë mes aleatëve”, tha Moses-Ones.

“Për dhjetë vite, Shqipëria e ka bërë aleancën tonë më të fortë nëpërmjet angazhimit të saj me trupa dhe burime në Afganistan, Kosovë, Bosnje dhe Irak, ndërmjet misionëve të tjera. Ajo i kushton 3.9 për qind të forcave të saj ushtarake aktiviteteve të NATO-s, duke u kthyer kështu në kontribuesen e dytë më të madhe të numrit të trupave për frymë në aleancë. Shqipëria do të vijojë ta bëjë aleancën më të fortë nëpërmjet investimit prej 58 milionë dollarësh për modernizimin e bazës ajrore të Kuçovës, e cila do të përforcojë operacionet e furnizimit nga ajri, mbështetjen logjistike, patrullimin ajror, trajnimet dhe stërvitjet. Roli shumë i madh i Shqipërisë në aleancë është shembull për të gjitha vendet aleate”, tha Moses-Ones.

Ndërsa duke folur për integrimin e Shqipërisë në BE, Moses-Ones theksoi se, “roli i Shqipërisë në NATO rritet së bashku me përgjegjësinë e saj për të bërë përparim të vazhdueshëm në reformat demokratike. Këto reforma janë themelore për vlerat që mbron aleanca dhe janë thelbësore për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian. Përparimi duhet të vazhdojë për të përmirësuar zbatimin e ligjit, çrrënjësien e korrupsionit e krimin të organizuar dhe krijimit të një ekonomie të fortë, që është e lirë dhe e barabartë për cilindo”.

Ajo nënvizoi angazhimin e palëkundur të SHBA-ve ndaj aleancës, teksa përmendi disa prej sfidave me të cilat përballen sot në rang ndërkombëtar, duke veçuar terrorizmin si një nga rreziqet që duhet mposhtur e luftuar me çdo kusht, sikurse edhe Rusinë, për përpjekjet e kësaj të fundit për të minuar demokracitë perëndimore.

Duke revokuar 70-të Vjetorin e NATO-s, e ngarkuara me punë në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, Leyla Moses-Ones, tha se “Më 4 prill 1949, ditën kur Shtetet e Bashkuara për herë të parë lidhën zyrtarisht sigurinë dhe mbrojtjen e tyre me ato të Europës. Përpara ceremonisë së nënshkrimit, Presidenti Harry Truman, me Sekretarin e Shtetit Dean Acheson në krah të tij, përkufizoi qëllimin e paktit si-“një mburojë kundër sulmeve, e cila do t’iu mundësojë qeverive të përqendrohen në arritjen e një jete më të plotë dhe më të lumtur për qytetarët e tyre”. Kjo mbetet aspirata kolektive e vendeve anëtare të NATO-s. Për 70 vjet, NATO ka ndihmuar për të krijuar periudhën më të sigurtë, më të qëndrueshme, dhe më të zhvilluar në historinë e anëtarëve



të saj. Nga zbrapsja e Bashkimit Sovjetik gjatë Luftës së Ftohtë deri tek goditja e kërcënimeve të shumfishta me të cilat përballemi sot, aleatët e NATO-s kanë qëndruar të bashkuar për të mbrojtur popujt tanë dhe për të ruajtur vlerat tek të cilat besojmë. Të bashkuar në një, kemi formuar aleancën më të suksesshme në histori. Kjo është trashëgimia jonë si aleatë të NATO-s. Kjo është trashëgimia që duhet të vazhdojmë të ndërtojmë ndërsa ecim përpara. Angazhimi i Shteteve të Bashkuara ndaj NATO-s është absolut. Anëtarët e NATO-s janë aleatët tanë parësorë. Kemi qëndruar përkrah-ushtarët tanë kanë luftuar dhe kanë dhënë jetën së bashku-në operacione larg kufijve të NATO-s, deri në Afganistan, ku NATO ka luftuar për më shumë se një dekadë. Falë aleancës së NATO-s, Shtetet e Bashkuara iu përgjigjen më mire-politikisht dhe ushtarakisht-kërcënimeve globale ndaj vlerave dhe interesave tona të përbashkëta. Përgjatë 70 viteve të fundit, e vetmja herë kur është përdorur Neni 5 i NATO-s ka qenë në mbështetje të Shteteve të Bashkuara pas sulmeve të 11 shtatorit”. “Kemi arritur suksese të mëdha gjatë këtyre 70 viteve, theksoi ajo, por puna jonë nuk ka mbaruar. Rusia është e vendosur që të minojë institucionet tona demokratike dhe të mbjellë përçarje midis dhe brenda vendeve tona. Kërcënimet e shumfishta ruse ndaj demokracive tona kanë përfshirë sulme me agjentë kimikë dhe aktivitete keqdashëse kibernetike. Ka pushtuar dhe zaptuar territore të Ukrainës dhe Gjeorgjisë, duke shkelur sovranitetin e këtyre vendeve. Rusia ka shkelur edhe Marrëveshjen për Armët Bërthamore me Rreze të Mesme, e cila gërryen themelet e kontrollit efikas të armëve dhe sigurinë Euro-Atlantike. Rusia është një kërcënim, por jo i

vetmi kërcënim. Korea e Veriut dhe Irani, udhëhequr nga regjimet e tyre mashtruese, kërcënojnë të përmbysin rendin botëror nëpërmjet taktikave të tyre të rrezikshme. Dhe, terrorizmi mbetet një kërcënim i vazhdueshëm dhe i përhershëm për aleancën tonë. NATO është sot po aq e rëndësishme për sigurinë tonë sot sa në çdo kohë të historisë sonë 70 vjeçare.

Përballë këtyre sfidave, Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara ndaj parimit se ne, si aleatë në NATO, do të jemi gjithnjë më të fortë nëse jemi të bashkuar. NATO është një aleancë ushtarake, por forca jonë e përbashkët

përfaqësojnë. Këto janë forca jonë më e madhe. Këto janë vlerat dhe parimet që përfaqësojmë dhe mbrojmë”.

“Për t’u rritur duke u mbështetur tek kjo forcë, Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara ndaj zgjerimit të anëtarësisë së NATO-s. Ne duhet t’i mbajmë dyert e NATO-s të hapura për anëtarë të rinj që ndajnë vlerat tona dhe premtimin tonë për mbrojtje të përbashkët. 13 vende i janë shtuar NATO-s që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Shtetet e Bashkuara e mbështesin fuqimisht anëtarësimin e Maqedonisë Veriore si aleatja e 30-të. Çdo aleat i ri ka forcuar mbrojtjen e përbashkët të

Në 2014, të gjithë aleatët e NATO-s ranë dakord për të shpenzuar në fushën e mbrojtjes të paktën 2 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto, si dhe për të investuar 20% të kësaj shume në pajisje të rëndësishme brenda vitit 2024. Ky angazhim i mban forcat tona të armatosura të forta, pajisjet tona moderne dhe aleancën tonë të zhdërvjellët teksa iu bëjmë ballë kërcënimeve të bashkuar. Premtimi që kemi bërë është një premtim që duhet ta mbajmë të gjithë”, tha Leyla Moses-Ones.

Në këtë kontekst ajo vlerësoi angazhimet e qeverisë Shqiptare. Zonja Leyla Moses-Ones, tha se “Shqipëria po punon fort për ta mbajtur këtë premtim, pavarësisht prioriteteve të tjera të shumta. Në 2017 bëri rritjen e parë të rëndësishme në shpenzimet për mbrojtjen-e para herë që nga koha kur iu bashkua aleancës në 2009. Tani dhe në vitet që do të vijnë, Shqipëria duhet të arrijë shpenzimin vjetor për mbrojtjen sipas objektivave që ka caktuar, deri në përmbyshjen e tyre në vitin 2024. Shtetet e Bashkuara e përgëzojnë Shqipërinë për angazhimin e saj në ndarjen e përgjegjësisë në NATO dhe mbështesin përpjekjet e saj të vazhdueshme drejt 2024-ës. Si aleatë të NATO-s, ne duhet të vazhdojmë të investojmë në mbrojtjen kombëtare, të rrisim dhe modernizojmë aftësitë tona ushtarake, dhe të kontribuojmë në përpjekjet e NATO-s për të promovuar mbrojtjen



vjen nga vlerat që ndajmë. Vjen nga angazhimi ynë i përbashkët ndaj të drejtave dhe përgjegjësisë që janë thelbësore për demokracitë tona, të tilla si liritë individuale që gëzojmë dhe integriteti e transparenca e qeverive që na

NATO-s dhe aftësinë e saj për të ruajtur paqen dhe mirëqenien tonë.

Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara ndaj premtimit që të gjithë aleatët kanë bërë për të ndarë barrën financiare të anëtarësimit në NATO.

dhe sigurinë e qytetarëve tanë. Tek kjo, jemi bashkë. Duke punuar së bashku do të jemi më të fortë dhe më të përgatitur për të mbrojtur paqen dhe mirëqenien tonë të përbashkët edhe për shumë kohë në të ardhmen”.

BATALIONI I FORCAVE SPECIALE

Realizohet me sukses stërvitja "GJALLICA-19"

Morën pjesë Kompania e Parë dhe Kompania e Katërt e Aksioneve Speciale Direkte, e mbështetur dhe nga një helikopter "Cougar" i Forcës Ajrore

Nga data 19-21 mars, batalioni i Forcave Speciale të Forcës Tokësore, zhvilloi stërvitjen "GJALLICA-19" në zonën e Lugut të Keq, Kukës. Në këtë stërvitje morën pjesë Kompania e Parë dhe Kompania e Katërt e Aksioneve Speciale Direkte, e mbështetur dhe nga një helikopter "Cougar" i Forcës Ajrore.

"GJALLICA-19", kishte për qëllim standartizimin dhe përmirësimin e procedurave standarte të veprimit në kryerjen e operacioneve speciale, (zbulim special dhe goditje objekti). Kjo stërvitje filloi me marrjen e urdhrat nga komanda eprorë

dhe kalim në planizim të mbyllur. Më pas zhvillimin e analizës së misionit, ndërtimit të kurseve të veprimit, krahasimi i kurseve të veprimit, përzgjedhja dhe ripërpunimi i kursit më të mirë të veprimit, ndërtimi i konceptit të operacionit.(CONOP) dhe në përfundim dhënia e brifingut para komandantit.

Faza e fundit e "GJALLICA-19" përfshinte zgjidhje detyre duke u infiltruar në zonën e operacionit grupet e sulmit, kalimi i grupit të zbulimit në grup mbështetje, realizim i detyrës (Goditje Objekti) dhe në fund eksfiltrimi.

Kjo stërvitje u ndoq edhe nga Komandan

danti i Forcës Tokësore general brigade Albert Mullai i cili në përfundim të saj përgëzoi të gjithë personelin e angazhuar, duke vlerësuar përgatitjen e lartë profesionale dhe disiplinën që ata treguan gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të ushtrimit stërvitor. Gjeneral Mullai shprehu besimin se kjo stërvitje ashtu sikurse edhe stërvitjet e tjera të zhvilluara deri tani nga trupat speciale të Forcës Tokësore do të ndikojë ndjeshëm për rritjen e mëtejshme profesionale të efektivave të batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore.

Major Edvin Zguro
Specialist i BCU, bFS



ARKIVI QENDROR I FORCAVE TË ARMATOSURA

Buletin me vlera arkivore



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Rreth buletinit

Më 21 mars 2019, Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura mbushi 55-vjet nga akti i themelimit. Në këtë kuadër u botua dhe Buletini Arkivor Usharak. Buletini Arkivor Usharak është një organ teoriko-arkivor i Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura. Në vitin 2019 ai vjen me një përmbledhje dokumentesh dhe shtypit "Mundimi", "Lirija e Shqipnis" 1944-1945. Në vitin 2019 janë disa përvjetorë të rëndësishëm të historisë tonë kombëtare si 75-vjetori i Çlirimit të vendit nga pushtuesi fashist, 20-vjetori i Çlirimit të Kosovës, si dhe 10-vjetori i anëtarësimit të Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Këto janë momente historike për kombin shqiptar kanë kaluar përmes sakrificave të panumërta. Prandaj dhe Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (AQFA) i administron dhe ju shërben me një fond të konsiderueshëm dokumente që hedhin dritë mbi historinë kombëtare, të cilat për nga sasia renditen pas Arkivit Qendror Shtetëror të Shqipërisë.

Hapja e arkivave dhe deklasifikimit i dokumenteve që përmbajnë informacion të klasifikuar, AQFA, mbështetur dhe në ligjin shqiptar për Arkivat, prej disa vitesh boton "Buletin Arkivor Usharak" (përmbledhje dokumentesh nga fondet arkivore). Botimi u vjen në ndihmë studiuesve për të pasuruar historinë kombëtare, mbështetur në dokumente arkivore të pa publikuara më parë.

Rëndësi të veçantë marrin dhe botimet periodike të shtypit të kohës, i cili kishte rol parësor në informimin, por edhe ndikimin e publikut. Në fondin arkivor të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare gjendet gazeta "Mundimi", që kishte karakterin e një buletini lufte. Nëpërmjet saj, publiku informohej për rezultatet e ushtrive aleate antifashiste (koalicioni anglo-sovjetiko-amerikan) kundrejt ushtrive armike të boshtit. Në një rubrikë të veçantë pasqyrohen lajme dhe thirrje drejtuar organizatave politike

për bashkim në luftën kundër pushtuesve hitlerianë.

Gazeta "Mundimi" botohej në Bari të Italisë nga Shtabi Aleat i Mesdheut (anglo-amerikan) i cili, në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, drejtonte dhe bashkërendonte veprimet luftarake ndaj pushtuesve gjermanë dhe aleatëve të tyre në zonën e Mesdheut dhe komandohej nga gjenerali Sir Henry Maitland Wilson.

Gazeta shpërndahej në Shqipëri nëpërmjet ajrit nga forcat ajrore britanike dhe amerikane (RAF dhe USA AF). Përballë shtypit aleat (anglo-amerikan), në qershor të vitit 1944, pushtuesit hitlerianë hodhën në tregun shqiptar gazetën me titull propagandistik "Liria Shqipnis" në gjuhën shqipe, si një buletin lufte, e cila jepte rezultatet e ushtrisë gjermane ndaj

Pjesë nga faqet e gazetës "Mundimi"

Gruaja shqiptare në faqet e buletinit. Sigurisht kjo luftë ka sjellë një ndryshim të madh në strukturën shoqërore. Kjo gjendje dallohet sidomos kur njeriu hedh sytë në kohërat që mund të quhen të afërta, si këtu e 20 vjet më parë, dhe prej asaj kohe e deri më sot sheh ndryshime rrënjësore. Në Rusi shohim gra që kanë fitue dekoratën më të madhe si pilota. Në Angli gratë punojnë ndër industritë më të rënda krah për krah me burrat. Në vendet e okupime, shohim prap gra, heroizmat e të cilave mbrin në kulm.

Lumturisht edhe një vend të vogël si tonin shohim se gruaja shqiptare me gjithë pa përgatitjen e saj, ka arritur me e ndihmue lëvizjen kombëtare gati po në atë shkallë të burrave. Ne shqiptarët që gjendemi në mërgim, këtë gjë e marrim në shënim. Lëvizja e gruas shqiptare në përpjekjet e saja për me i ndihmue vëllezërit të tyre që luftojnë për me dëbue armikun është një mallëngjim për ne. Dërdhim lot gëzimi dhe kemi një argument më të fortë në dorë për t'u treguar aleatëve se,

Shqipëria nuk është më vetëm ajo e burrave, por janë edhe gratë shqiptare që po i dalin zot asaj. Do të dëshironim me këtë rast të përmendim emra zonjash dhe zonjushash, që ato me zgjuarësinë e tyre kanë bërë vepra të shkëlqyeshme kundër armikut, e njëkohësisht tue i ndihmue çështjes kombëtare, porse për arsyen që dihet prej të gjithëve e me qëllim që të mos e zgjojmë armikun për me pengue lëvizjen e tyre, i mbajmë të mfisheta. Si do të jetë heroizma e tyre në këtë përpjekje, ka vënë gurin që shënon etapën e parë për Shqipërinë e ardhshme të lirë.

Një mike e Shqipërisë ka ndërruar jetë. Në këtë faqe jepet dhe njoftimi se Miss Edith Durham, një mike e Shqipërisë ka ndërruar jetë. Miss Durhami erdhi në Shqipëri për herë të parë 40 vjet më

parë dhe qysh atëherë nuk ka pushuar së punuari për të mirën e Shqipërisë dhe për të drejtat e shqiptarëve. Ajo bëri ç' ishte e mundur që ta bënte Shqipërinë të njohur ndër rrethet përgjegjëse angleze, për këtë punë ajo shkroi libra, artikuj gjithfarësh, mbajti konferenca dhe foli gjithmonë për të drejtën e Shqipërisë. Në vitin 1918 ajo shkoi në Shkodër për t'i shpjeguar gjithë nevojat e Shqipërisë admiralit Burney, i cili në atë kohë mbante Shkodrën me anë e një fuqie ndërkombëtare, për t'ia dorëzuar qeverisë shqiptare. Më 1914 ajo shkeli kufirin greko-shqiptar për të parë zhvillimin e ngjarjeve atje. Gjatë Luftës së Parë Botërore Durham ishte anëtare e Shoqërisë Anglo-Shqiptare dhe punonte për pavarësinë e Shqipërisë që ishte në rrezik atë kohë. Në fillim të luftës kjo shoqëri u reformua nën udhëhijën e zonjës Anbrey Herbert bashkë me Durhanin, si një nga anëtarët më të rëndësishëm. Durhani pati njohur shqiptarët të pasur dhe të varfër, pleq e të rinj, në një mënyrë që rrallë tjetër kush ka mundur të njohë. Miss Durhami jetoi mjaft sa mbriti me i pa shqiptarët të luftojnë kundër pushtuesit italianë dhe gjermanë. Ajo ndërroi jetë, por Shqipëria humbi një mikeshë më të sinqertë të admirueshme dhe përkrahëse të madhe të popullit shqiptar.

1912-1944. 28 nëntor 1944 është përvjetori i 32 i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë nga Ismail Qemali më 1912. Qysh prej vitit 1912 Shqipëria ka kaluar ndër shumë shkelje të huaja dhe ndër shumë vuajtje të ëmdha. Mipëro sot asaj i hapen horizonte të reja drejt një lirie të vërtetë më shumë më tepër shpresë se san ë kohën e kalume.

Një fitore shqiptare e shkëlqyer. Më 1912 zgjedha shekullore turke mori fund. Më 1944 zgjedha e shkurtër më e pamëshirshme gjermane po merr fund. Mbështetësit e ushtrisë famëkeqe gjermane tash gjenden në Shkodër të rrethuar në jugë dhe në lindje nga njësitë e UPVNÇ shqiptare deh në të vetmen rrugë shpëtimi përmes Malit të Zi të prerë nga njësitë Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave. Të gjithë pjesët e tjera të Shqipërisë janë të çliruara. Kryeqyteti vetë u çlirua nga Korpamata e Parë e UPVNÇ Shqiptare mbas një lufte epike që zgjati afër tri

javë dhe që do të shënohet në Historinë e Shqipërisë si fitorja më e madhe e fitime nga vet ushtarët shqiptarë.

Fuqitë e Mëdha. Ato Fuqi të Mëdha që më 1913 përkrahën Pavarësinë e Shqipërisë dhe dërguan në Shqipëri një princ gjerman të padëshiruar, pas pak muajsh shpërthyen në një luftë të rreptë kundra njera-tjetrës, në Luftën e Parë Botërore. Mirëpo tash të gjitha Fuqitë e Mëdha, që po luftojnë kundër armikut të përbashkët, janë lidhë me një aleancë, që lindi në këtë luftë e që nuk ka për t'u prishë më kurrëme gjithë propogandën gjermane. Anëtarët e kësaj aleance, Anglia, Rusia dhe Amerika, në dhjetor të vitit 1942, shpallën zyrtarisht se Shqipëria do të jetë e pavarur mbas lufte. Në këtë mënyrë pavarësia e Shqipërisë është sigurue jo vetëm nga ana e Ushtrisë së saj heroike, por edhe me anën e deklartave të këtyre të tria Fuqive të Mëdha, të cilat nuk kanë ndërmend t'ju dërgojmë një princ të huaj e t'ju ndërhyjnë në punët e regjimit të juaj të mbrendshëm.

Një e ardhme më me shpresë. Shqipëria e vitit 1944 është krejt ndryshe prej asaj të vitit 1912. Në kohën e Ismail Kemal Vlorës, Shqipëria ishte shumë më e varfër dhe shumë e prapambetur në sa ishte sot. Ajo nuk kishte asnjë eksperiencë më parë administratë deh qeveritare dhe ata të paktë një administrativë që kishte, ishin të një kohe dhe të një mentaliteti të vjetër dhe të ndryshkura. Sot njerëzit përgjegjës për rindërtimin e Shqipërisë kanë se ku të gjejnë mësues, mjekë, njerëz të administratës dhe të tjerë, të gjithë shqiptarë. Ata do të mundohen të kuptojnë gabimet e të së shkuarës dhe të përfitojnë nga to, tue i përmirësue dhe tue mos i përsëritë më. Ata do të mundin të bëjnë Shqipërinë një vend të përparuar me rrugë, telefon, makina dhe çdo gjë tjetër, që t'i apë këtij vendi një pamje më të vërtetë tërhekëse...

Urimet tona. Për më se një vit e gjysëm ne i kemi ndihmu këtyre ushtarëve me armë dhe me municione dhe shpresojmë se kjo ndihmë i ka hy në punë Shqipërisë. Me gjithë këto ne e dimë fare mirë se nderi më i madh u takon këtyre njerëzve të palodhur e jo armëve që u kemi dhënë ne. Ne jemi të lumtur dhe e duajmë për nder që kemi mundë të bëjmë diçka për lirinë e juaj dhe që tash mundemi t'ju urojmë dhe t'ju përshëndesim për Pavarësinë e Atdheut të juaj.



Autoritetet vendore janë kthyer në “qendra” konstatimi

NGA HAKI ÇAKO
Drejtor i Përgjithshëm
i Emergjencave Civile

Zjarret janë shkaktuar në mënyrë të qëllimshme

Në tre javë, janë konstatuar 69 vatra zjarri, ku janë djegur 167 hektarë, sipërfaqe me kullota, pemëtari dhe pyje, duke sjellë pasoja në ekonomi ashtu dhe mjedis



e ndjekin në kohë marrjen e informacionit, në fazën fillestare të konstatimit të vatrës së zjarrit si dhe të angazhimit të gjitha strukturat, institucionet, vullnetarët dhe komunitetin. Nëse secili nga

ju bën detyrën dhe zbaton ligji, askush, për interesa personale apo politike nuk do të mund të dëmtojë pasurinë kombëtare e mbi të gjitha të cenojë sigurinë e qytetarëve shqiptarë.

BATALIONI I MBËSHTETJES RAJONALE

Dy zjarrfikëse dhe 45 forca për shuarjen e zjarrit në Qafë Mollë

Dy vatra të mëdha zjarri kanë përfshirë mesditën e kësaj të hëne, më 25 mars, një sasi të konsiderueshme sipërfaqe toke në fshatin Qafë Mollë në njësinë administrative Dajt, Tiranë, duke vënë në rrezik jo vetëm shtëpitë e banorëve të këtij fshati por edhe disa ish objekte ushtarake, tashmë jo funksionale. Duke u favorizuar nga era e fortë zjarri ka përparuar me shpejtësi duke djegur një sasi të konsideruar pemësh dhe shkurresh që gjendeshin në atë zonë. Batalioni i Mbështetjes Rajonale dhe ai i Furnizimit i Komandës Mbështetëse, në bashkëpunim me strukturat e Emergjencave Civile si dhe banorët e këtij fshati, bënë të mundur neutralizimin e zjarrit që në pak minuta mori përmasa të frikshme duke rrezikuar jetën e banorëve dhe banesave për rreth. Në këtë operacion morën pjesë rreth 45 forca të batalionit të Mbështetjes Rajonale si dhe batalionit të Furnizimit, 2 zjarrfikëse dhe 3 mjete të kalueshmërisë së lartë.



SHPLLJE VEND I LIRË PUNE

Specialist për infrastrukturën dhe Mjedisin, KDS

Fillimi i aplikimit nga data 22 mars 2019 deri në 6 prill 2019

Repartit/Institucioni: Reparti Ushtarak nr. 5001, KDS, në pozicionin e punës: specialist për infrastrukturën dhe mjedisin, shpall vend të lirë pune, “Specialist për infrastrukturën dhe Mjedisin”-KDS. Mënyra e aplikimit është me dosje dhe intervistë, dhe lloji i kontratës së punës: 1-vjeçare. Fillimi i aplikimit nga data 22 mars 2019 deri në 6 prill 2019

Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al. Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t’i dërgohet Njësisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuar, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën (adresa postare e repartit/strukturës përkatëse): Psh. Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit Ministria e Mbrojtjes Rruga e Dibrës

Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme: kërkesën; formularin e aplikimit; fotokopje të kartës së identitetit; diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të notizuara ose në origjinal; dëshmi profesioni nëse ka; certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja raport mjekësor; fotografi me përmasa 4x6, 2 copë; dëshmi penaliteti; vërtetim nga gjykata; vërtetim nga prokuroria; librezë pune; jetëshkrimin (CV), formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: Baza ligjore/Akte ligjore/Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetëdeklarimit).

Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

Të ketë shtetësinë shqiptare; të jetë jo më pak se 18 vjeç; të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar; të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara; të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore; të mos jetë dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi; të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

Grada/Titulli: Specialist për Infrastrukturën dhe Mjedisin. Arsimi: Master Shkencor, Inxhinieri Mjedisin. Kualifikimi: kualifikime në fushën përkatëse. Trajnimi: - e. Eksperienca në Punë: mbi 1 vit. Gjuha e huaj: N/A g. Kërkesa të tjera specifike: Niveli i certifikatës së sigurisë.

Përshkrimi i punës:

Detyrat kryesore: Drejton në bazë të dispozitivave ligjore në fuqi, punën për organizimin, funksionimin e sektorit të menaxhimit të garnizoneve. Drejton procesin e përgatitjes së project-planeve të infrastrukturës sipas nevojave prioritare të operacionalitetit. Organizon, drejton punën për hartimin dhe përpilimin e udhëzimeve, programeve, metodikave për infrastrukturën dhe mjedisin. Drejton hartimin e detyrave të projektimit për institucionet e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Ndjek hartimin e projekteve dhe preventivave të përgatitura nga IGJIU për detyrat e projektimit të dërguara. Harton urdhrat, udhëzime, raporte e tematika për infrastrukturën, pronat dhe mjedisin. Përgatit raporte periodike për

gjendjen e infrastrukturës, pronave, mjedisit dhe zhvillimin e tyre. Ndjek zbatimin e planit të investimeve të parashikuara në KDS. Përgatit project-planin e investimeve për infrastrukturën për institucionet vartëse të KDS, bazuar në master planet dhe përparësitë e fondet në dispozicion. Drejton procesin e hartimit të master planeve të institucioneve vartëse. Bashkërendon e ndjek punën për hartimin e detyrave të projektimit dhe i dërgon në afat në SHPPA. Ndjek hartimin e project-preventivave për objektet e KDS nga IGJIU. Kontrollon punën e bërë nga institucionet vartëse për hartimin sipas kërkesave të përcaktuara të masterplaneve dhe detyrave të projektimit. Ndjek dhe kontrollon zbatimin e ligjshmërisë në fushën e ndërtimit. Ndjek dhënien e objekteve me qera të tretëve dhe realizimin e të ardhurave të tyre.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një komision vlerësimi i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin: përzgjedhjen paraprake; vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse; intervistën e strukturuar me gojë. Përzgjedhja paraprake e kandidatëve do të realizohet nga Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcaktonë kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

Vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse; intervistën e strukturuar me gojë. Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen: 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve; 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë. Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin: vlerësimin e jetëshkrimit (CV); vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike; vlerësimin e trajnimeve; vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës; Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë: jetëshkrimi, 5 pikë; arsimimi apo kualifikimi, 15 pikë; trajnimi, 5 pikë; eksperiencia ose përvoja në punë, 15 pikë. Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë. Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës. Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë. Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur. Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile po ndjekin me shqetësim situatën e pazakontë të ditëve të fundit, kur me dhjetëra vatra zjarri kanë përfshirë sipërfaqe të shumta, në disa njësi administrative në thuajse të gjitha prefekturat.

Që prej datës 3 mars e deri më 25 mars, pra në 22 ditë, janë konstatuar 69 vatra zjarri, të cilat kanë djegur 167 hektarë, sipërfaqe me kullota, pemëtari dhe pyje, të konsideruara si zona të mbrojtura, duke sjellë pasoja shumë të mëdha si në ekonomi ashtu edhe në mjedis.

Sipas analizës së bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, në të gjitha rastet, kjo situatë, e cila, e përsëris, është e pazakontë për stinën është shkaktuar në mënyrë të qëllimshme. Të gjitha vatrave të zjarrit janë ndezur nga dora e njeriut, duke synuar djegien e shkurreve, ferrave e barishteve të thata për hapjen e tokave të reja për kullota apo krijimin e hapësirave për ndërtim. Me keqardhje vërejmë se, përballë një realiteti të tillë, autoritetet vendore mjaftohen vetëm me konstatimin e problemit, apo kërkesat për ndërhyrje nga ajri, ndërkohë që heshtin, kur bëhet fjalë për marrjen e masave parandaluese për raste të tilla, të përsëritura çdo vit, apo akoma më keq, për identifikimin dhe vënien përpara përgjegjësisë të shkaktarëve të zjarrit. Për të gjithë ata drejtues vendorë, qofshin kryetarë bashkish apo kryetarë njësisish administrative, të cilët bëjnë veshin shurdh, ju rikujtoj se, bazuar në ligjin për “Për emergjencat civile”, “Ligjin për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi”, si dhe të gjitha akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, pushteti vendor është përgjegjësi direkt për: organizimin e masave parandaluese, ruajtjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullotave dhe identifikimin e vatrës fillestare dhe autorëve me përgjegjëshmëri maksimale.

Të gjitha strukturat shtetërore, institucionet e pushtetit vendor dhe komuniteti, jo vetëm që duhet të kontribuojnë në parandalimin dhe eliminimin e këtyre fenomeneve, por edhe të denoncojnë në kohë, të gjithë autorët e zjarrvënies duke e konsideruar atë si një vepër penale, e cila sjell pasoja të rënda për normalitetin e shoqërisë sonë, ekonominë dhe mjedisin.

Çdo neglizhencë në këtë drejtim ju ngarkon me përgjegjësi të drejtpërdrejtë, pasi rrezikohen të krijohen precedentë të rrezikshëm që cenojnë sigurinë e komunitetit dhe pasurisë së përbashkët kombëtare.

Ju bëj thirrje të gjithë punonjësve të administratës vendore apo qendrore, punonjësve të administrimit dhe ruajtjes së pyjeve dhe zonave të mbrojtura, si qytetarëve të denoncojnë në numrat 112, 129 si dhe në nr. +355 69 411 0198 të Qendrës Kombëtare të Emergjencave Civile, çdo individ apo grup individësh që konstatohen në zjarrvënie.

Njëherësh, kërkojmë nga policia e shtetit dhe prokuroria një bashkëpunim më efikas në identifikimin, ndalimin dhe arrestimin e të gjithë autorëve të zjarrvënies me dashje dhe vënien e tyre përpara përgjegjësisë ligjore.

Strukturat e Emergjencave Civile dhe MZSH në bashki dhe prefektura duhet jo vetëm të angazhohen kapacitete e tyre, por edhe të sensibilizojnë

Bashkëpunimi NATO-Gjeorgji

Stoltenberg: Të përgatishim Gjeorgjinë për anëtarësimin në NATO

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, nënvizoi rëndësinë dhe forcën e partneritetit midis NATO-s dhe Gjeorgjisë gjatë vizitës në Gjeorgji më 25 mars 2019. Stoltenberg ishte atje për të vëzhguar nga afër stërvitjen NATO-Gjeorgji, trajnimin i cili kishte në fokus përmirësimin e aftësive të forcave gjeorgjiane dhe të NATO-s për të punuar së bashku. Duke folur në konferencën e përbashkët për shtyp me Kryeministrin Mamuka Bakhtadze, Sekretari i Përgjithshëm tha se ushtrimi tregon se si Aleanca dhe Gjeorgjia po rrisin bashkëpunimin e tyre. Gjatë vizitës së tij Stoltenberg pati bisedime me Presidentin e Gjeorgjisë, Salome Zourabichvili, Kryeministrin Mamuka Bakhtadze dhe zyrtarë të tjerë të nivelit të lartë.

Gjeorgjia është një partner unik për NATO-n

Vlerësimi e bashkëpunimit NATO-Gjeorgji e bëri Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, në kofrerencën e Përbashkët për shtyp me Kryeministrin e Gjeorgjisë, Mamuka Bakhtadze.

“Është një kënaqësi e madhe të rikthehem në Tbilisi për të vizituar Gjeorgjinë gjatë stërvitjes NATO-Gjeorgji. Kjo është hera e dytë që Gjeorgjia pret këtë ngjarje të rëndësishme, demonstrimin e aftësisë të forcave të armatosura gjeorgjiane për të vepruar krah për krah me aleatët dhe partnerët e tjerë”, tha në fillim të deklaratës së tij Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. “Ky ushtrim organizohet nga Qendra e Përbashkët e Trajnimeve NATO-Gjeorgji e cila ka punuar për të forcuar mbrojtjen e vendit tuaj që kur u inaugurua në vitin 2015. Ju kam vizituar shumë herë dhe gjithmonë është mirë të kthehem dhe këtë herë, do të vizitoj stërvitjen GEO të NATO-s”, tha ai.

Duke theksuar në fjalën e tij se “Gjeorgjia është një partner unik për NATO-n” ai tha se verën e kaluar në Bruksel të gjithë udhëheqësit e NATO-s rikonfirmuan vendimin e Bukureshtit që nga viti 2008 që Gjeorgjia do të bëhet anëtare e NATO-s. “Ju jeni kontribuesi më i madh, jo anëtar i NATO-s, në Misionin Mbështetës të Përhershëm në Afganistan. Ju kontribuoni në Forcën e Reagimit të NATO-s dhe ushtrimi NATO-Gjeorgji këtë javë demonstroi se ne po forcojmë bashkëpunimin tonë. Gjeorgjia ka bërë shumë përparim në reforma të rëndësishme. Përfshirë forcimin e rolit të parlamentit në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë dhe reforma e gjyqësorit të Gjeorgjisë. Isha i lumtur të dëgjoja se këto përpjekje do të vazhdojnë”, nënvizoi Sekretari



i Përgjithshëm i NATO-s, lidhur me reformat e ndërmara për institucionet e Gjeorgjisë, si dhe për reformat në institucionet e mbrojtjes dhe në shpenzimin 2% të PBB-së.

“Përpjekjet tuaja për modernizimin e forcave të armatosura dhe për të ndërtuar institucione mbrojtëse më efektive kanë qenë gjithashtu shumë mbresëlënëse. Unë gjithashtu e mirëpres përkushtimin tuaj për të shpenzuar 2% të PBB-së në mbrojtje dhe përgëzoj Gjeorgjinë për shpenzimin e 20% të PBB-së në pajisje dhe modernizim. Kjo forcon ushtrinë tuaj dhe kontributin tuaj për sigurinë rajonale. Unë i mirëpres përpjekjet tuaja në të gjitha këto fusha dhe ju inkurajoj që të vazhdoni të përdorni plotësisht të gjitha mundësitë për t’u afruar më pranë Aleancës dhe për t’u përgatitur për anëtarësim”.

Stoltenberg tha se NATO mbështet plotësisht integritetin territorial të Gjeorgjisë brenda kufijve të saj të pranuar ndërkombëtarisht. “Ne i bëjmë thirrje Rusisë që t’i japë fund njohjes së rajoneve të Abkhazisë dhe Osetisë së Jugut dhe të tërheqë forcat e saj. Ne gjithashtu ndajmë shqetësimet tuaja rreth vendosjeve ushtarake të Rusisë në rajonin e Detit të Zi. Kjo është arsyeja pse ne po forcojmë bashkëpunimin midis forcave tokësore të Gjeorgjisë dhe NATO-s. Pse po japim trajnime për ekipet e Rojes Bregdetare të Gjeorgjisë dhe arsyeja përse Komanda

Detare e NATO-s po bashkëpunon me Qendrën e Përbashkët Operacionale të Gjeorgjisë”. Duke ju referuar takimit me kryeministrin gjeorgjian Stoltenberg informoi se bashkëpunimi i mëtejshëm midis NATO-s dhe Gjeorgjisë do të vazhdojë. “Gjatë takimit tonë sot kemi diskutuar se si mund ta rrisim bashkëpunimin, e jo më pak midis forcave tona detare”.

Në fund të fjalës së tij Sekretari i Përgjithshëm falënderoi kryeministrin për mikpritjen dhe tha se Gjeorgjia është një kontribues i rëndësishëm ndërsa ecën

drejt NATO-s. “Ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku për të përgatitur Gjeorgjinë për anëtarësimin në NATO. Gjeorgjia është një kontribues i besueshëm për sigurinë tonë të përbashkët. Pres që të vazhdoj të punoj me ju, ndërsa Gjeorgjia i afrohet NATO-s.”

Gjeorgjia partneri më i afërt i Aleancës në rajonin e Detit të Zi

Ushtrimi NATO-Gjeorgji mbloshi rreth 350 pjesëmarrës nga 24 vende të NATO-s dhe vende part-

